



Në bazë të nenit 77- a paragrafi 1 dhe 2, nenit 77 – b, 77 – v, 77- g dhe 77-d nga Ligji për Kulturë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16 dhe 11/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 265/24) dhe nenit 20 -g nga Ligji për të Punësurit në Sektorin Publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 143/19, 14/20 dhe 208/24), në pajtim me Marrëveshjen Kolektive për Kulturë („Gazeta Zyrtare e RMV nr. 10/20), Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike dhe fletëparaqitjes për punësim, mënyrën e mbajtjes së audicionit, si dhe mënyrën e vlerësimit me pikë varësisht nga kategoria dhe niveli i vendit të punës për të cilin është publikuar shpallja publike në IN TEATRI SHQIPTAR Shkup nr. 01-28/1 nga 04.02.2021 dhe Lajmërimin nr.19-7605/2 nga 17.07.2025 dhe nr.19-7610/2 nga 17.07.2025 nga Ministria e Financave për mjete të siguruara financiare, lidhur me Vendimin për publikimin e shpalljes publike nr. 04-321/1 nga 18.07.2025, IN TEATRI SHQIPTAR Shkup shpall:

SHPALLJE PUBLIKE NR.01/2025 për punësim në kohë të caktuar

IN TEATRI SHQIPTAR Shkup ka nevojë për punësim në kohë të pacaktuar të dhënësve të shërbimeve publike:

- 1. KUL 0304 A06 001 aktor i grupit të katërt... tre (3) realizues**
- 2. KUL 0304 G03 003 bashkëpunëtor për veprimtari të dramës... një (1) realizues**

Kandidati duhet t'i plotësoj këto:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të jetë i moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës; dhe
- me aktgjykim të plotëfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim për ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Kushte të veçanta:

Për vendin e punës:

- niveli i arsimit 240 kredi sipas EKTS ose të ketë të mbaruar nivelin VII/1 Artet Dramatike (drejtimi aktor) / arsim i mesëm;
 - përvoja e punës: deri në një (1) vjet në lëmi; dhe
 - niveli më i lartë i njohjes së gjuhës shqipe
- niveli i arsimit: i lartë: shkencat humane dhe artet: shkencat humane të tjera (arti figurativ, artet dramatike)/ arsim i mesëm: gjimnazi;
 - përvoja e punës: deri në një (1) vjet në lëmi; dhe
 - niveli më i lartë i njohjes së gjuhës shqipe

Orari i punës:

- ditë pune: sipas programit të institucionit;
- orari javor i punës: 40 orë.

Neto rroga mujore:

Për vendin e punës:

1. 53.806

2. 42.723

Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjes për punësim:

Fletëparaqitja për punësim dorëzohet më së voni 15 ditë nga publikimi i shpalljes. Forma e Fletëparaqitjes për punësim mund të merret në ueb faqen e IN TEATRI SHQIPTAR Shkup www.teatri.mk.

Fletëparaqitja dorëzohet në letër në arkivin e IN TEATRI SHQIPTAR Shkup çdo ditë pune nga ora 10.00 – 12.00 ose përmes postës në adresën rr.Nikolla Martinovski nr.41, 1000 Shkup. Me fletëparaqitjen dorëzohen edhe dëshmitë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta:

- vërtetim për shtetësinë (jo më i vjetër se 6 muaj);
- kopje e letër njoftimit;
- vërtetim mjekësor për gjendjen e përgjithshme shëndetësore (jo më i vjetër se 6 muaj);
- vërtetim se nuk i është shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës (jo më i vjetër se 6 muaj);
- dëshmi për kryerjen e shkollimit përkatës (original ose kopje e verifikuar në noter);
- dëshmi për përvojën e punës.

Mënyra e realizimit të procedurës për përzgjedhje:

Procedura për përzgjedhje përbëhet nga përzgjedhja administrative dhe audicioni për vendin e punës numër 1, gjegjësisht përzgjedhje administrative dhe intervistë për vendin e punës numër 2. Kandidatët të cilët me sukses do të kalojnë përzgjedhjen administrative ftohen në audicion për të kontrolluar aftësitë artistike të kandidatit, gjegjësisht intervistë për të kontrolluar aftësitë e nevojshme për vendin e punës.